



Refik Issa Bikun

ETIKA ISLAME E BIZNESIT





ETIKA ISLAME E BIZNESIT

Etika islame e biznesit (Albanian)

Refik Issa Bikun

Copyright © Center for Advanced Studies and the International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1442AH / 2021CE

ISBN: 978-608-216-214-0 Paperback

Translated into Albanian from the English Title:

Islamic Business Ethics

Rafik Issa Beekun

Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1417AH / 1997CE, Reprint 1427AH / 2006CE

ISBN: 1-56564-242-2 Paperback

IIIT
P.O. Box 669
Herndon, VA 20172, USA
www.iiit.org

IIIT London Office
P.O. Box 126
Richmond, Surrey
TW9 2UD, UK
www.iiituk.com

PËRKTHIMI
KORREKTIMI LETRAR
FAQOSJA DHE DIZAJNI
BOTUES

Osman Osmani
Agim Abazi
Suhejb Xhemaili
Furkan ISM
www.furkan.com.mk / furkan@furkan.com.mk
Furkan ISM, Shkup

SHTYPI

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe dispozitave të marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, nuk lejohet asnjë riprodhim i asnjë pjese, pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë libër janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë medoemos edhe ato të botuesit. Botuesi nuk mban përgjegjësi për saktësinë e adresave të jashtme, ose të faqeve të internetit të palëve të treta, të cituara në këtë botim, dhe nuk garanton se përmbajtja e faqeve të tilla është ose do të vazhdojë të jetë e saktë ose e përshtatshme.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

174:28

BEEKUN, Rafik Issa

Etika islame e biznesit / Refik Issa Bikun ; përkthimi Osman Osmani. - Shkup : Furkan ISM, 2021. - 128 стр. ; 21 см


Превод на делото: *Islamic business ethics* / Rafik Issa Beekun. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-216-214-0

а) Деловна етика -- Ислам

COBISS.MK-ID 54041349

Refik Issa Bikun



ETIKA ISLAME E BIZNESIT


Përkthimi:
Osman Osmani



Shkup, 2021




Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i
Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



Përmbajtja

Parathënie	7
Etika islame e biznesit	9
Përkufizimi i etikës	11
Faktorët që ndikojnë në sjelljen etike	13
Interpretimet ligjore	13
Faktorët organizativë	15
Faktorët individualë	16
Sistemi etik islam	21
Sistemet alternative të etikës	22
Aksiomat e filozofisë etike islame	36
Shkallët e sjelljes së ligjshme dhe të paligjshme në Islam ..	47
Zonat e biznesit <i>hallall</i> dhe <i>haram</i>	51
Fitimi hallall	51
Fitimi haram	55
Zhvillimi i një klime organizative etike	61

Perspektiva islame mbi përgjegjësinë shoqërore të organizatave.....	63
Palët e interesit.....	63
Mjedisi natyror	80
Mirëqenia e përgjithshme shoqërore.....	84
Argumente për dhe kundër përgjegjësisë shoqërore	85
Format organizative të përgjegjësisë shoqërore.....	87
Menaxhimi i përgjegjësisë shoqërore	91
Qasjet e qarta organizative.....	91
Qasjet e nënkuptuara të organizatës.....	97
Auditimi shoqëror	98
Udhëzime të përgjithshme etike për muslimanët në biznes.....	101
Jini të sinqertë	101
Mbajeni fjalën.....	102
Dojeni Allahun më shumë sesa tregtinë	103
Me muslimanët para jomuslimanëve	103
Jini të përlulur	104
Këshillohuni.....	104
Mos mashtroni.....	104
Mos merrni ryshfet	105
Silluni drejtësisht.....	105
Ndëshkimi dhe pendimi për sjelljen jo etike	107
Nuk ka detyrim në sjelljen etike	107
Filozofia e ndëshkimit në Islam	109
Ushtrime eksperimentale dhe pyetësorë	111
Dilema etike e Rexhep Salihut.....	111
Një test etik.....	115
Eksplorimi i naftës dhe gazit (Malajzia) Ltd.....	119
A mund ta kaloni këtë test të punës?.....	123
Ushtrim mbi etikën: Aventurat e Samiut	127



ME EMRIN E ALLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT

Parathënie

Etika islame e biznesit shënjestron biznesmenët muslimanë, të cilët, domosdo, duhet t'u ekspozohen rrethanave etike, çdo ditë. Libri pasqyron parimet kryesore të menaxhimit nga pikëpamja islame. I lutem Allahut që kjo vepër modeste t'i shërbejë qëllimit për të cilin është shkruar - pra, t'i ndihmojë biznesmenët të sillen në përputhje me sistemin etik të Islamit.

Si autor, mbaj përgjegjësi të plotë për të gjitha pikëpamjet e shprehura në të. Veç tjerash, kërkoj falje për çdo lajthitje eventuale që, mbase mund të më ketë kaluar pa e vërejtur. Falënderoj Dr. Ikbal Unusin dhe Nadie Bikunin për komentet e tyre, të cilat më tej e pasuruan librin. Në fund fare, falënderoj edhe Dr. Ahmed Sakriun dhe Gamal Badaviun për inkurajimin dhe udhëzimin e pashembullt në rrugëtimin tim drejt materializimit të këtij libri.

Dr. Refik I. Bikun
Universiteti i Nevadas
1 nëntor, 1996



Etika islame e biznesit

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun..." (Ali Imran: 110)

Çdo ditë, në çdo kohë, në çdo vend, njerëzit përballen me çështje etike në punën e tyre, dhe rrallëherë dinë të sillen etikisht. Një përmbledhje e artikujve të fundit të botuar në *Wall Street Journal*, në vitin 1991, nxori në shesh një varg problemesh me të cilat përballeshin punonjësit, si: vjedhje, gënjeshtria, mashtrim, hile, etj.¹ Studimet e bëra, si në ShBA ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, vënë në pah sjelljet e shfrenuara jo etike në kontekstin biznesor. Për shembull, një studim i kohëve të fundit i 2.000 korporatave kryesore amerikane, gjeti se problemet vijuese etike (të përshtatura sipas rëndësisë) lidheshin me menaxherët: (1) abuzimi me droga dhe alkool, (2) vjedhja nga punonjësit, (3) konflikti i interesit, (4) çështjet e kontrollit të cilësisë, (5) diskriminimi në punësimin dhe ngritja në detyrë, (6) keqpërdorimi i informacionit të pronarit, (7) abuzimi me llogaritë e shpenzimeve të kompanisë, (8) mbyllja e impianteve

1 Cherrington, J. O. dhe Cherrington, D. J. 1993. "Menyja e Çështjeve Morale: Një Javë në Jetën e Wall Street Journal". *Journal of Business Ethics*, 11, f. 255-265.


dhe pezullimi nga puna, (9) keqpërdorimi i aseteve të kompanisë dhe (10) ndotja e mjedisit.² Edhe në planin ndërkombëtar, vlerat etike të bizneseve janë të mangëta. Në një studim të 300 ndërmarrjeve në të gjithë botën, mbi 85% e drejtuesve të lartë treguan se çështjet vijuese ishin ndër shqetësimet kryesore të tyre: konfliktet e interesit të punonjësve, dhuratat e pavenda, ngacmimet seksuale dhe pagesat e paautorizuara.³

A llogaritet naivitet që biznesmeni musliman të sillet në mënyrë etike në një mjedis global, konkurrues? Përgjigjja është një JO kumbuese! Në Islam, etika rregullon të gjitha aspektet e jetës. Kushtet për sukses të përhershëm ose *fale* në Islam janë të njëjta për të gjithë muslimanët - qoftë në çështjet biznesore ose në aktivitetet e përditshme. Pa specifikuar ndonjë kontekst situatë, Allahu i përshkruan njerëzit e suksesshëm si syresh që “ftojnë në gjithçka që është e mirë (*hajr*), që urdhërojnë atë që është e drejtë (*ma’ruf*) dhe që ndalojnë nga ajo që është e gabuar (*munkar*).”⁴ Megjithatë, brenda një konteksti biznesor, cilat standarde specifike të sjelljes duhet t’i ndjekë një ndërmarrje? Cila është përgjegjësia e një biznesmeni musliman ndaj aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm? Megjithëse drejtuesit më të lartë të një ndërmarrje mund të shfaqin sjellje etike shembullore, si mund të inkurajohen menaxherët e nivelit të mesëm dhe të ulët që të sillen në një mënyrë të ngjashme etike? Cilat janë udhëzimet që do të siguronin sjellje etike të qëndrueshme te një biznes musliman?

2 Problemët etike më të shpejta të Amerikës. 1990. Washington, DC: The Ethics Resource Center, f. 1.

3 Bauman, Mary. 1987. “Etika në biznes”. *USA Today*. Citon të dhëna nga Bordi i Konferencës.

4 Kurani, Ali Imran: 104.




Përkufizimi i etikës

Etika mund të përkufizohet si një tërësi e parimeve morale, të cilat veçojnë atë që është e drejtë nga ajo e gabuara. Është një fushë normative, sepse përshkruan atë që njeriu duhet ta bëjë ose nga e cila duhet të abstenojë. Etika e biznesit, ndonjëherë referuar si etika e menaxhimit ose etika organizative, thjesht kufizon kornizën e saj të referimit për organizatat.

Brenda një konteksti islam, termi që më së ngushti lidhet me etikën, në Kuran, është *huluk*.⁵ Kurani përdor një tërësi termash për të përshkruar konceptin e mirësisë: *hajr* (mirësi), *birr* (drejtësi), *kist* (barazi), *adl* (ekuilibër dhe drejtësi), *hak* (e vërtetë dhe e drejtë), *ma'ruf* (e njohur dhe e miratuar) dhe *takva* (devotshmëri). Veprat e ndershme përshkruhen si *sahihat*, ndërsa të pandershmet si *sejji'at*.⁶

5 Kurani 68: 4. Falënderoj Dr. Xhemal Badaviun për këtë sugjerim.

6 Fahrij, Mexhid. *Teoritë etike në Islam*. Leiden: E. J. Brill. 1991, f.12-13.



Faktorët që ndikojnë në sjelljen etike


Ajo që llogaritet etike, mbase varet nga faktorët që përkufizojnë dhe ndikojnë në sjelljen etike. Këta faktorë janë identifikuar në Figurën 1.

INTERPRETIMET LIGJORE

Në shoqëritë laike, interpretimet ligjore bazohen në vlera dhe standarde bashkëkohore dhe shpesh kalimtare; në një shoqëri islame, këto vlera dhe standarde drejtohen nga sheriatu dhe gjykimet e *fikhut*. Rezultati i qasjeve të tilla divergjente është mahnitës: në një kohë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishte i ligjshëm dhe etik diskriminimi i grave dhe pakicave gjatë punësimit; tani kjo është i paligjshëm. Në anën tjetër, Islami u ka dhënë grave të drejta të përhershme dhe të patjetërsueshme, dhe asnjëherë nuk i ka diskriminuar minoritetet mbi çfarëdo baze. Për shembull, transmeton Ebu Dherri se i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], kishte thënë:

“Nuk ka vlerë as i kuqi ndaj të ziut dhe as i ziu ndaj të kuqit, përveçse me devotshmëri.”⁷

Figura 1
Përcaktuesit e etikës individuale⁸



Ngjashëm, sistemi etik islam nuk e miraton konceptin e paralajmërimit *emptor* (lat. *caveat emptor*), të cilin shumë gjykata perëndimore e vlerësojnë të vlefshme në disa raste të paqarta. Enes ibën Maliku transmeton hadithin vijues:

“I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ka ndaluar shitjen e frutave, derisa ato të jenë pothuajse të pjekura. U pyet se çfarë nënkuptohet me “pothuajse të pjekura”, dhe ai u përgjigj: “*Derisa ato të bëhen të kuqërremta.*” I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], më tej kishte thënë: “*Nëse Allahu prish frytet, çfarë të drejte do të kishte dikush që t’i merrte paratë e vëllait të vet (d.m.th. njerëzve të tjerë)?*”⁹

Interpretimi hanefi mbi ligjin islam përforcon këtë theks mbi barazinë dhe drejtësinë:

7 Ebu Dherri, *Mishkat El-Masabih*, 5198 dhe transmetuar nga Ahmedi.

8 Barney, Jay B. & Griffin, Ricky W. *Menaxhimi i organizatave*. 1992 nga Houghton Mifflin Company, f. 720. Përshtatur me leje.

9 Enes ibën Maliku, *Sahih El-Buhari*, 3.403.

“Nëse pala shitëse shet një gjësend për një cilësi të caktuar, të dëshirueshme, dhe gjësendit të shitur i mungon cilësia e tillë, atëherë blerësi mund ta anulojë shitjen, ose ta pranojë gjësendin e shitur për tërë çmimin fiks. Kjo quhet alternativë për përshkrimin e pasaktë.”¹⁰

FAKTORËT ORGANIZATIVË

Edhe organizata mund të ndikojë në mirësjelljen e pjesëmarrësve në të. Një nga burimet kryesore të ndikimit organizativ është shkalla e angazhimit të udhëheqësit të organizatës në sjelljen etike. Ky angazhim mund të komunikohet përmes kodit etik, politikave, fjalimeve, botimeve, etj. Për shembull, *Xerox Corporation* ka një kod etik 15 faqesh, një pjesë e të cilit thotë:

“Ne jemi të singertë me klientët tanë. Asnjë marrëveshje, asnjë sistem veprimesh, asnjë ryshfet, asnjë sekret, asnjë marrëzi me çmimet. Një marrje-dhënie haraçi, në çfarëdo forme, e largon këdo. Këdo.”

Deklarata e mësipërme është e qartë dhe ka të bëjë me sjelljen specifike jo etike, pra, me pasojat negative.

Kodet e etikës, gjithnjë e më shumë, po fitojnë popullaritet në shumë organizata, dhe shpesh ndryshojnë nga një industri në tjetrën. Edhe pse kodet e tilla mund ta ngritin sjelljen etike ndërmjet pjesëmarrësve të organizatës, ndonjëherë, përdorimi i tyre është i papërshtatshëm. Disa organizata mund të tregtojnë ose të shesin *hamr*, ose produkte e shërbime të tjera të ndaluara (*haram*), dhe në këtë rast, sjellja e gjithë organizatës është jo etike. Zhvillimi dhe zbatimi i një kodi etik në këtë lloj organizate është qartë i gabuar, pasi Allahu i Lartësuar ka thënë në Kuran:

10 El MaxhAllah (Manuali i Gjykatave Osmane [Hanefi], Seksioni 11. Alternativa për Përshkrim të Pasaktë, f. 310.

“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaj: “Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre...” (El-Bekare: 219)

Në përgjithësi, megjithatë, organizatat e përfshira në biznese të lejuara (*hallal*) mund të nxisin sjellje etike përmes zhvillimit të një kodi etik islam.

FAKTORËT INDIVIDUALE

Individët kanë vlera të ndryshme. Faktorët që ndikojnë në sjelljen etike përfshijnë: fazat e zhvillimit moral, vlerat personale dhe morale, ndikimet familjare, ndikimet kolegjiale dhe përvojat e jetës.

Fazat e zhvillimit moral

Ka thënë i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], që individët u nënshtrohen dy fazave të zhvillimit moral: fazës së vogël ose para pubertetit dhe fazës së rritjes. Në një hadith të transmetuar nga Aishja, [radijallahu anha], thuhet:

“I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ka thënë: *“Janë veprat e tre njerëzve që fare nuk regjistrohen: atij që fle derisa të zgjohet, të marrit derisa t’i rikthehet arsyes dhe fëmijës derisa ta arrijë pubertetin.”*¹¹

Nga hadithi i mësipërm, mund t’i nxjerrim dy gjëra: së pari, disa njerëz nuk janë përgjegjës për sjelljet e tyre, si: i fjeturi, i çmenduri dhe fëmija para pubertetit. Së dyti, njeriu nuk është përgjegjës për veprimet e tij deri në moshën e arsyes.

11 Aishja, Um El-Mu’minin, Ebu Davud, 4384.

Përveç zhvillimit fizik dhe mendor, studiuesit islamë¹² pajtohen që ekzistojnë tri gjendje ose faza të zhvillimit të shpirtit njerëzor ose *nefsit*: (1) *amare* (12:53), e cila është e prirë drejt së keqes dhe, nëse nuk kontrollohet, çon në shkatërrim; (2) *lavame*, (75: 2), e cila ndien vetëdije për të keqen dhe i reziston asaj, kërkon mirësinë dhe faljen e Allahut pas pendimit dhe përpiket të ndryshojë; shpreson të arrijë shpëtimin; (3) *mutma'ine* (89:27), faza më e lartë e të gjithave, kur shpirti arrin prehje të plotë dhe kënaqësi pasi *akl-i* (intelekti) t'i ketë kontrolluar prirjet e liga të njeriut.¹³ Nëse një musliman vazhdon të sillet joetikisht, ai në realitet i nënshtrohet *amare-së*; nëse ai sillet në përputhje me mësimet islame, në realitet i lufton impulsset e liga të *amare-së* dhe iu përgjigjet udhëzimeve të *lavame-së* dhe *mutma'ine-së*. Pa dyshim, ajo që do ta orientojë sjelljen etike dhe bashkëveprimin ndërmjet këtyre tri gjendjeve të shpirtit, është niveli i tij i *takva-së* ose devotshmërisë. Në varësi të nivelit në të cilin është *nefsi* i tij - pra nëse ai është duke fituar ose duke humbur betejën kundër tundimit dhe së keqes - ai mund të jetë pak a shumë i prirë ndaj sjelljes etike.

Vlerat personale dhe personaliteti

Vlerat dhe morali ndikojnë në standardet e njeriut. Një njeri që nderon do të sillet shumë më ndryshe nga një tjetër që nuk respekton pasurinë e të tjerëve. Në Islam, prishja dhe zhdukja eventuale e ndershmërisë është një shenjë e afrimit të Ditës së Gjykimit. Transmeton Ebu Hurejre:

“Ndërsa Profeti Muhamed, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], po predikonte, erdhi një beduin dhe e pyeti: “Kur do të vijë Ora (pra, Kijameti)?” I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem],

12 Rizvi, S. A. *Tradita muslimane në psikoterapi dhe trendet moderne*. Lahore, Pakistan: Instituti i Kulturës Islame.

13 Po aty, f. 50-51.

vazhdoi predikimin; disa thanë se ai, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e kishte dëgjuar pyetjen, por nuk i kishte pëlqyer ajo. Të tjerët thanë se nuk e kishte dëgjuar pyetjen fare.

Pasi Mustafaja, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], mbaroi së predikuari, pyeti: *“Ku është ai që pyeti për Orën (Kijametin)?”* “Ja ku jam, o i Dërguari i Allahut.” - u përgjigj beduini. Atëherë, ai që u pyet për Orën, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], u përgjigj: *“Kur amaneti të humbasë, atëherë pritni Orën (Kijametin).”* Beduini pyeti tutje: *“Si vallë do të humbasë amaneti?”* I pyeturi u përgjigj: *“Kur fuqia ose autoriteti të vijë në duart e njerëzve jomeritorë, atëherë prisni për Orën (Kijametin).”*¹⁴

Një variabël kyç i personalitetit, i cili mund të ndikojë në sjelljen etike të një individi është qëndrimi. Qëndrimi ndikon në shkallën në të cilën njeriu percepton sjelljen e tij dhe nga ndikimi në jetën e tij. Një individ ka qëndrim të brendshëm, nëse ai/ajo beson se mund t'i kontrollojë ngjarjet në jetën e tij/saj. Për rrjedhojë, brendësia ka të ngjarë të marrë përgjegjësi për rezultatet e sjelljes së tyre. Në anën tjetër, një individ me qëndrim të jashtëm beson se fati ose njerëzit e tjerë ndikojnë në jetën e tij. I tilli ka të ngjarë të besojë se forcat e jashtme e shtynë atë të silllet qoftë në mënyrë etike qoftë jo etike.¹⁵

Ndikimet familjare

Individët nisin të formojnë standarde etike qysh në fëmijëri. I Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], vuri në pah rëndësinë e edukimit familjar kur tha:

14 Sahihu i Buhariut, 1.56.

15 Lefcourt, H. M. *Qëndrimi: Trendet aktuale në teori dhe kërkime*. Hillsdale, NJ: Erlbaum, 1982, botimi i dytë.

“Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz, kur t’i kenë mbushur të shtatat dhe disiplinojini për të (namaz), kur t’i kenë mbushur të dhjetat; ndani gjithashtu shtretërit!”¹⁶

Pra, nëse dëshironi që fëmijët tuaj të rriten si muslimanë të mirë, atëherë modeloni ata që në moshë të vogël. Fëmijët, mbase mund të zhvillojnë standarde të larta etike, nëse i perceptojnë anëtarët e tjerë të familjes si, vazhdimisht respektues të standardeve të larta, dhe nëse shpërblehen për sjellje etike, por edhe ndëshkohen nëse janë të pasinqertë, nëse vjedhin etj. Mesazhet e përziera nga prindërit mbase rezultojnë në sjellje jo etike te fëmijët. Një shembull i tillë është ai, kur fëmijëve u thuhet se vjedhja është e keqe, por në të njëjtën kohë, atyre u jepen furnizime të “huazuara” nga zyra e prindërve në punë.

Ndikimet kolegjiale

Ndërsa fëmijët rriten dhe ndjekin mësimet në shkollë, ata ndikohen nga bashkëmoshatarët me të cilët ndërveprojnë çdo ditë. Kështu, nëse miqtë e tyre merren me vizatime grafiti, edhe këta mund ta bëjnë të njëjtën, pra, t’i imitojë ata. Nëse bashkëmoshatarët e tij shmangin një sjellje të tillë, edhe këta ka të ngjarë të sillen ashtu.

Përvojat e jetës

Qofshin pozitive ose negative, ngjarjet kryesore ndikojnë në jetën e individëve dhe përcaktojnë bindjet etike dhe sjelljen e tyre. Përvoja e haxhit të Malcolm X, pati një ndikim të madh në vitet e tij të mëvonshme si musliman:

16 Abdullah ibën Amër ibën El-Asi, Ebu Davud, 0495. Gjatë diskutimit të këtij hadithi me Dr. Xhemal Badaviun, ai tregoi se Islami nuk promovon “goditje” të ashpra ndaj fëmijëve. Ata, në vetvete, duhet t’i ndjekin modelet e paraqitura nga prindërit e tyre dhe duhet t’i falin namazet e rregullta deri në moshën dhjetëvjeçare. Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë duhet të praktikohet një disiplinë e lehtë, por e përshtatshme.

“Kishte dhjetëra mijëra pelegrinë, nga e gjithë bota. Ishin të të gjitha ngjyrave, nga biondë me sy blu tek afrikanë me lëkurë të zezë. Por, të gjithë po merrnim pjesë në të njëjtin ritual, duke shfaqur një frymë uniteti dhe vëllazërie, që përvoja ime në Amerikë, më kishte bërë të besoja që kurrë nuk do të mund të ekzistonte dhe ndërvepronte i bardhi me jo të bardhin.

Amerika duhet ta kuptojë Islamin, sepse kjo është feja e vetme që fshin nga shoqëria e saj problemin e racës. [...] Kurrë në jetën time nuk kam parë vëllazëri të singertë dhe të vërtetë, të praktikuar nga të gjitha ngjyrat së bashku, pa dallim.

Mund të tronditeni nga këto fjalë, por në këtë pelegrinazh, ajo që kam parë dhe përjetuar, më ka detyruar t'i rirregulloj shumë nga modelet e të menduarit që kisha më parë dhe të hedh mënjanë disa nga përfundimet e mia të mëparshme.”¹⁷

Faktorët e situatës

Njerëzit mund të sillen në mënyrë jo etike në situata të caktuara, sepse mund të mos shohin rrugëdalje fare. Për shembull, një menaxher mund të regjistrojë shitje fiktive, që t'i mbulojë humbjet brenda zonës së tij të përgjegjësisë. Sipas Islamit, borxhi është një arsye kryesore, pse individët sillen në mënyrë jo etike. Në një hadith të transmetuar nga Aishja, [radijallahu anha], gjejmë:

“E pyeti njëri të Dërguarin e Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “Përse kaq shpesh kërkon strehim tek Allahu nga borxhi?” I Dasheduri i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], iu përgjigj: “*Borxhliu gënjën sa herë që flet dhe thyen premtimin sa herë që premtton.*”¹⁸

Meqenëse borxhi ka të ngjarë të çojë në sjellje në mënyrë jo etike, borxh dhënësit muslimanë inkurajohen të tregojnë butësi ndaj borxh marrësve. Në të njëjtën kohë, borxh marrësve u kërkohet të paguajnë borxhet menjëherë.

17 Haley, Alex. 1965. *Autobiografia e Malcolm X*. New York: Ballantine Books, f. 340.

18 Aishja, Sahih El-Buhari, 1.795.



Sistemi etik islam

Sistemi etik islam ndryshon nga sistemet etike laike dhe nga kodi moral i mbështetur nga fetë tjera. Në çdo qytetërim, këto modele¹⁹ laike supozuan kode morale kalimtare dhe miopike, të cilat, që prej asaj kohe bazoheshin në vlerat e themeluesve të tyre njerëzorë, p.sh. epikurianizmi ose lumturia për hir të lumturisë. Këto modele zakonisht propozuan një sistem etik të shkurorëzuar nga feja. Në të njëjtën kohë, kodi moral i miratuar nga fetë tjera shpesh ka nënvizuar vlera që de-theksojnë ekzistencën tonë në këtë botë. Për shembull, krishterimi me nënvizimin e tepërt të murgërisë inkurajon ithtarët e tij të tërhiqen nga ngutja dhe nxitimi i jetës së përditshme. Në anën tjetër, kodi moral i ngulitur në etikën islame nënvizon marrëdhënien e krijesës me Krijuesin e Tij. Meqë Zoti është i Përsosur dhe i Gjithëdijshëm, muslimanët kanë një kod që nuk është as i kufizuar në kohë dhe as i njëanshëm nga tekat njerëzore.²⁰ Kodi islam i etikës është i zbatueshëm në çdo kohë, sepse Krijuesi dhe Mbikëqyrësi është më afër njeriut sesa damari i tij i qafës dhe ka

19 Badavi, Xhemal. *Mësime islame*. Halifax, NS Kanada. Paketa 11, seria F, kaseta 1 dhe 2.

20 Cituar më parë

dije të përjetshme dhe të përsosur. Për të germëzuar kodin moral të Islamit, tani do t'i krahasojmë sistemet alternative të etikës me sistemin etik islam.

SISTEMET ALTERNATIVE TË ETIKËS

Etika bashkëkohore dallon nga sistemi etik islam në shumë mënyra. Gjashtë sisteme etike tani dominojnë të menduarit etik në përgjithësi. Këto janë përmbledhur në Tabelën 1.

Relativizmi

Relativizmi thekson se asnjë kriter unik, universal nuk mund të përdoret për të përcaktuar nëse një veprim është etik ose jo. Secili njeri përdor kriterin e tij ose të saj, dhe ky kriter mund të dallojë nga kultura në kulturë. Si rezultat, karakteri etik i vlerave dhe sjelljeve të ndryshme shoqërore shihet brenda konteksteve specifike kulturore.²¹ Prandaj, biznesmenët që merren me aktivitete në një vend tjetër, janë të detyruar nga normat dhe vlerat e atij vendi.

Disa probleme shoqërohen me këtë sistem etik. Së pari, shkolla relativiste është e përqendruar te vetja; ajo përqendrohet vetëm tek individit dhe përjashton çdo bashkëveprim me ose in-pute nga jashtë.²² Kjo qasje është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Islamin. Islami nënvizon që sjellja etike dhe vlerat e një individit duhet të bazohen në kriteret e shpallura në Kuran dhe Sunet. Së dyti, relativizmi nënkupton një dembelizëm të qenësishëm të vendimmarrësi; ai ose ajo mund të justifikojë

21 Weiss, f. 64.

22 Cituar më parë.

sjelljen e tij ose të saj duke iu referuar thjesht kritereve të bazuara në interesin personal. Në anën tjetër, Islami qëndron larg vendimeve të bazuara vetëm në perceptimin e dikujt mbi një situatë. Parimi i konsultimit ose *shura* me të tjerët është një pjesë e brendshme e aparatit vendimmarrës të biznesmenit musliman. Egoizmi nuk ka vend në Islam.

Tabela 1Përmbledhje e gjashtë sistemeve të mëdha etikore²³

Sistemet etike alternuese	Kriteret e vendimmarrjes
Relativizmi (Vetë-interesi)	Vendimet etike merren në bazë të vetë-interesit dhe nevojave.
Utilitarizmi (Kalkulimi i kostove dhe përfitimeve)	Vendimet etike merren në bazë të rezultateve që rezultojnë nga këto veprime. Një veprim është etik nëse rezultojnë në përfitimin më të madh për numrin më të madh të njerëzve.
Universalizmi (Detyrat)	Vendimet etike nënvizojnë qëllimin e vendimit dhe veprimit. Vendimet e ngjashme duhet të arrihen nga secili, nën rrethana të ngjashme.
Të drejtat (E drejta individuale)	Vendimet etike nënvizojnë vlerën dhe lirinë, dhe janë të bazuara në të drejtat e individëve që sigurojnë liri të zgjedhjes.
Drejtësia shpërndarëse (Paanësia dhe barazia)	Vendimet etike nënvizojnë vlerën dhe drejtësinë, dhe sigurojnë një shpërndarje të barabartë të pasurisë dhe përfitimit.
Ligji i përhershëm (Shpallja)	Vendimet etike bëhen në bazë të ligjit të përhershëm, i cili shpallet në Shpallje.

23 Përshtatur me leje nga Weiss, J. W. *Etika e Biznesit: Një Qasje Menaxheriale e Palëve të Interesit*. Belmont, CA: Wadsworth Publishing, 1994. Riprodhuar me leje nga botuesi.

Utilitarizmi

Nga Cicero te Jeremy Bentham dhe J. S. Mill, qasja utilitare ndaj etikës ka mbijetuar gati dy mijë vjet tani. Ajo konstaton se “vlera morale e sjelljes personale mund të përcaktohet vetëm nga pasojat e asaj sjellje.”²⁴ Një veprim është etik, nëse ai rezulton në dobinë më të madhe ose “të mirë” për numrin më të madh të njerëzve. Prandaj, utilitarizmi²⁵ është shumë i orientuar drejt rezultateve.

Problemet që lidhen me këtë sistem etik janë të shumta. Së pari, kush e përcakton se çfarë është “e mirë” për numrin maksimal të njerëzve? Është pasuria, kënaqësia apo shëndeti? Së dyti, çfarë ndodh me pakicën? Nëse shumica në ShBA vendos që doktrina e dashurisë së lirë do të sundojë token, atëherë kush do t'i mbrojë interesat e pakicës që beson në martesë dhe marrëdhënie monogame siç përcaktohet nga Zoti? Së treti, si duhet të vlerësohen kostot dhe përfitimet kur trajtohen çështjet e pakuantifikueshme, siç është shëndeti? Së katërti, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale shpërfillen në favor të të drejtave dhe përgjegjësiwe kolektive.²⁶ Kjo është në kundërshtim me Islamin, sepse Islami i konsideron të rëndësishme, si të drejtat individuale ashtu edhe ato kolektive. Për më tepër, një musliman nuk mund ta fajësojë *umetin* për veprimet e tij; secili njeri është, përfundimisht, përgjegjës për veprimet e tij ose të saj, si individ.

“(Përkujto) Ditën që vjen kur secili njeri do të përpiqet për vetveten dhe secilit njeri do t’i plotësohet ajo që e meriton, e nuk u bëhet padrejt.” (En-Nahl: 111)

Së fundmi, utilitarizmi përcakton natyrën etike të veprimeve të ardhshme, duke peshuar kostot e tyre kundrejt përfitimeve të

24 Hosmer, f. 109.

25 Po diskutojmë akt utilitarizmin dhe jo rule utilitarizmin.

26 Weiss, 67.

tyre, dhe lehtë mund të çohet në një ekstrem. Ky rrezik mund të shihet lehtësisht në qasjen e mikroekonomisë ndaj etikës së biznesit, e cila dominon pjesën më të madhe të mendimit të linjës fundore të biznesit perëndimor.

Mikroekonomia nënvizon rregullin e optimitetit, *pareto optimality*. Ky rregull thekson përdorimin efikas të burimeve për t'i përmbushur dëshirat e konsumatorit, përjashton çdo nevojë për të marrë në konsideratë çështjet etike dhe mbivlerëson maksimizimin e fitimit.

Në kundërshtim me qasjen mikroekonomike ndaj etikës së biznesit, maksimizimi i fitimit nuk është qëllimi përfundimtar ose rezultati i vetëm etik i tregtisë në Islam. Allahu i Lartësuar ka thënë në Kuran:

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë.” (El-Kehf: 46)

Universalizmi

Për dallim nga utilitarizmi, universalizmi përqendrohet në qëllimin e vendimit ose veprimit. Parimi kryesor i shkollës së universalizmit është parimi i *urdhëresave të prera* të Kantit. Ky parim është i dy pjesshëm. Së pari, njeriu duhet të veprojë, vetëm nëse ai/ajo është i gatshëm t'i lejojë të gjithë, në një rrethanë të ngjashme, të marrin vendim të njëjtë të drejtë dhe të veprojnë në të njëjtën mënyrë.²⁷ Së dyti, të tjerët duhet të trajtohen si qëllime, të denjë për dinjitet dhe respekt, dhe jo vetëm si mjete drejt një qëllimi. Për rrjedhojë, kjo qasje përqendrohet në *detyrën* që një individ i detyrohet individëve të tjerë dhe njerëzimit.

Problemet me universalizmin kanë të bëjnë me atë që Kanti nënkuptonte me *detyrë*.²⁸ Sipas tij, veprimi ynë llogaritet etik, vetëm

27 Weiss, 68.

28 William H. Shaw. *Etika e biznesit*. Belmont, CA: Wadsworth, 1991, f. 57.

kur veprojmë sipas detyrës. Nëse veprojmë thjesht nga ndjenja ose interesi vetjak, atëherë veprimi ynë nuk ka ndonjë vlerë morale. Islami, gjithashtu, shikon qëllimin e njeriut që kryen një veprim.

Alkame ibën Vekas El-Lajthi ka thënë: “E kam dëgjuar Omerin, ndërsa ishte në *minber* (foltore) duke predikuar: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “O ju njerëz! Dijeni që veprat vlerësohen sipas qëllimit dhe çdo njeri do ta ketë atë që ka për qëllim. Kështu, ai, emigrimi i të cilit ishte për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, emigrimi i tij është për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe ai, emigrimi i të cilit ishte për të arritur ndonjë përfitim të kësaj bote ose për t’u martuar me ndonjë grua, emigrimi i tij është për atë për të cilin ai emigroi.”²⁹

Megjithatë, qëllimet e mira, si të vetme, nuk e bëjnë veprën jo etike, etike. Siç theksohet nga Jusuf El-Kardavi: “Qëllimet e mira nuk e bëjnë të ndaluarën (*haramin*) të pranueshme (*hallall*).”³⁰ Sa herë që një musliman ndjek një qëllim të mirë me një veprim të lejueshëm, veprimi i tij bëhet një akt adhurimi. Në të vërtetë, i Dërguari i Allahut, [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ka thënë:

“Çdo ditë, duhet dhënë lëmoshë për çdo kockë të trupit. Përsëritja është lëmoshë; urdhërimi për të mirë është lëmoshë; ndalimi nga e keqja është lëmoshë; largimi i pengesës nga rruga është lëmoshë; kryerja e marrëdhënieve seksuale me bashkëshorten është lëmoshë.” U pyet për këtë të fundit nga habia: “Por ai e përmbush dëshirën e tij, o i Dërguari i Allahut; llogaritet kjo lëmoshë?” Ai u përgjigj: “Më thoni, nëse ai do ta përmbushte dëshirën e tij (seksuale) në të ndaluar, a do të kishte mëkatuar?” [...]”³¹

Për më tepër, nëse një vepër është e ndaluar (*haram*), atëherë Islami nuk lejon që ajo të përdoret si mjet për ta arritur një

29 Omer ibën El-Hatabi, Sahih El-Buhari, hadithi nr. 1.1.

30 El-Kardavi, Jusuf. *Hallalli dhe harami në Islam*. Indianapolis, USA: American Trust Publications, f. 11.

31 Ebu Dherri, Ebu Davud, hadithi nr. 5223.

RRETH LIBRIT

Ky libër u drejtohet anëtarëve të komunitetit të biznesit, të cilët duhet të merren me rrethana etikore në baza ditore.

Libri ofron parimet kryesore të menaxhimit nga pikëpamja islame. Qëllimi i tij është t'i ndihmojë muslimanët e përfshirë në biznes, të sillen në përputhje me sistemin etik të Islamit.

Përvoja e autorit me veprimtari të ndryshme islame, i jep atij një formim praktik që mbështet dijen e tij akademike në fushat vitale të menaxhimit dhe administrimit të biznesit.



Refik Bikun është profesor i Menaxhmentit dhe strategjisë në Universitetin e Nevadas. Ai është autor i Planifikimi strategjik dhe zbatimi për organizatat islame, bashkëautor i Lidershipi: një perspektivë islame dhe ka ofruar shumë trajnime për udhëheqësit e niveleve të larta drejtuese dhe thirrësit islamë. Aktualisht, ai është President i Shoqatës së Shkencëtarëve Muslimanë (ShBA).



ISBN 978-608-216-214-0

